



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
SEKTORI MËSIMOR & KURRIKULËS, INFORMIMIT TË STUDENTËVE,
KËSHILLIMIT TË KARRIERËS DHE ALUMNI

Procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit të kandidatëve nga Republika e Kosovës, kandidatëve me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatëve me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe të kandidatëve të pakicave rome dhe egjiptian, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e ciklit të parë të studimeve, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë.

| Viti Akademik 2024 - 2025 / Kreu V | | Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit |
|---|---|--|
| 1. | Kreu V, pika 1 Kandidatët nga Republika e Kosovës me origjinë shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci, kandidatët me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët e pakicave rome dhe egjiptian, aplikojnë pranë IAL-ve, në datat e përcaktuara, në programet e studimit ku janë parashikuar kuotat përkatëse nga IAL-të. | 02 – 13 shtator 2024 |
| 2. | Kreu V, pika 2 Kandidatët që aplikojnë në programe studimi për të cilat është parashikuar konkurs pranimit aplikojnë pranë IAL-ve respektive deri më datën e përcaktuar në kalendar. | 13 shtator 2024 |
| 3. | Konkurset e pranimit do të zhvillohen në datën e përcaktuar në kalendar. | 16 shtator 2024 |
| 4. | Kreu V, pika 10 IAL-të kryejnë procesin e përzgjedhjes së kandidatëve fitues në bazë të kriterëve të përcaktuara nga ana e tyre, si dhe për çdo program studimi që ofrojnë, ato publikojnë listat e renditjes së kandidatëve dhe formulën/mënyrën e përzgjedhjes. Gjithashtu IAL-të në datën e përcaktuar, publikojnë në mjedise të dukshme të fakulteteve, dhe faqen e tyre elektronike zyrtare listën paraprake të fituesve, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. | 18 shtator 2024 |
| 5. | Kreu V, pika 12 IAL-të shpallin listat përfundimtare të kandidatëve fitues të identifikuar me ID-në e kandidatit, në faqet elektronike zyrtare dhe në mjediset e fakulteteve, në datën e përcaktuar, duke respektuar përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. | 26 shtator 2024 |
| 6. | Kreu V, pika 13 Kandidatët regjistrohen vetëm në njërin nga programet e studimit ku janë shpallur fitues brenda datës së përcaktuar. | 26 shtator – 03 tetor 2024 |
| 8. | Kreu V, pika 14 IAL-të brenda datës së përcaktuar në kalendar, sekretaritë mësimore të fakulteteve për kuotat e paplotësuara njoftojnë kandidatët të renditur sipas listës së shpallur, të cilët nuk janë regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. | Pas datës: 04 tetor 2024 |
| 9. | Kreu V, pika 15 IAL-të brenda datës së përcaktuar në kalendar, përfundojnë të gjithë regjistrimin e kandidatëve fitues sipas dokumenteve të dorëzuar në momentin e aplikimit. | 10 tetor 2024 |